

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

RAPORT VJETOR

2021



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

SHKURTIME

AN	Akt Normativ i Këshillit të Ministrave
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FUZR	Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale
GoA/QSH	Government of Albania - Qeveria Shqiptare
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
PIUTD	Project for Integrated Urban and Tourism Development

Misioni dhe orientimi i aktivitetit: Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organizatë zhvillimore që shënon një eksperiencë 28-vjeçare në zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke iu përgjigjur sfidave dhe partnerëve të saj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në ligjin bazë nr. 10 130, datë 11.5.2009, FSHZH-ja synon përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike vendore, përmirësimin e shërbimeve publike vendore, forcimin institucional të njësive të qeverisjes vendore, si dhe nxitjen e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Gjithashtu, ligji 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, duke përcaktuar FSHZH-në si Sekretariat i Komitetit Kombëtar dhe Sekretariat i Bordeve të Monitorimit, i ngarkon një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të Zhvillimit Rajonal nga njëra anë, dhe nga ana tjetër cakton FSHZH si Autoritet Menaxhues me përgjegjësinë për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe arrijtjen e objektivave e treguesve të matshëm.

Në këtë mënyrë, viti 2021 ka shënuar një zgjerim të rolit të FSHZH-së përgjatë gjithë ciklit të jetës së zhvillimit, si një organizatë që mbështet hartimin e politikave të zhvillimit rajonal, ka një rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit, menaxhon dhe implementon në bashkëpunim me NJVV programet dhe projektet zhvillimore, mbështet hyrjen në treg si një operator zhvillimi, duke ngritur dhe vënë në funksionim modele të integruara zhvillimi në partneritet me njësitë vendore etj.

Procesi i konsultimeve publike në kuadër të akteve nënligjore në zbatim ligjit të ri 102/2020, filloi më 17.12.2020 dhe përfundoi edhe në 08.04.2021. Ky proces u zhvillua me pjesëmarrjen e aktorëve institucionalë dhe jo-institucionalë të 4 rajoneve zhvillimore në Shqipëri, duke konsistuar në një cikël prej 26 takimesh në total, me 183 aktorë të përfshirë nga bashkitë, qarqet, institucione të decentralizuara, shoqëria civile, bizneset, qendrat e dijes, organizata jofitimprurëse etj.

Në kuadër të thirrjes së dytë për propozime për Skemën e Granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (publikuar më 15 korrik 2021), u administruan 61 aplikime prej të cilave 55 u dorëzuan nga bashkitë e vendit. Vlerësimi i aplikimeve fituese u mbyll në 24 Shtator 2021 dhe nga ky proces u përzgjedhën 20 propozime fituese, të cilat vijuan më tej konkurimin në fazën e dytë, gjatë muajit Nëntor 2021. Në përfundim të procesit, u përzgjedhën 9 aplikime të cilat do të financohen në kuadër të këtij granti.

Financimi i aktivitetit dhe realizimi i limiteve buxhetore: Gjatë vitit 2021, FSHZH ka pasur në zbatim 11 programe/projekte me financim të huaj dhe 4 programe me financim të brendshëm.

Realizimi financiar i buxhetit 2021, krahasuar me buxhetin fillestar të miratuar me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, rezulton në masën 161%, përkatësisht për programet me financim të brendshëm realizimi është 175%, për programet me financim të huaj 62 % dhe për Programin e Rindërtimit është 361%. Ndërkohë, gjatë vitit 2021, si pasojë e rishikimeve të limiteve të financimit nëpërmjet Akteve të ndryshme ligjore, ku i fundit është AN nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, realizimi në total i buxhetit të FSHZH rezulton në masën 92%, ku disa aplikime për pagesa direkte të dërguara pranë financuesve të disa programeve nuk arritën të konfirmoheshin brenda vitit ushtrimor financiar 2021. Ndaj, realizimi financiar i programeve me financim të huaj rezulton në masën 74%, ndërkohë që realizimi financiar për programet me financim të brendshëm është në masën 96%, ndërsa realizimi financiar i Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti është në masën 98%.

Prokurimi dhe kontraktimi i shërbimeve: Gjatë vitit 2021 janë ndjekur dhe zhvilluar gjithsej 187 procedura prokurimi. Nga këto peshën kryesore e zënë procedurat për “Punë” me rreth 85 procedura dhe “Shërbim/Shërbim konsulence” me rreth 91 procedura të zhvilluara dhe finalizuara me nënshkrimin e kontratave.

Përsa i përket vlerës për kontratat e nënshkruara gjatë vitit të shkuar, rezulton se në total janë rreth 21.92 mld lekë me tvsh të përfshira në këto kontrata. Nga këto, rreth 50% të vlerës totale të kontratave e zënë kontratat e nënshkruara në zbatim të Programit të Rindërtimit; rreth 13% të vlerës e zënë kontratat e nënshkruara në zbatim të programit të investimeve të QSH dhe rreth 37% kontratat e nënshkruara në zbatim të programeve të financimit të huaj.

Referuar procedurave të prokurimit të cilat kanë konkluduar me kontrata të nënshkruara, rezulton se, nga Fondi Limit prej rreth 29.8 mld Leke me tvsh, janë kursyer rreth 7.8 mld lekë, të cilat përbëjnë 26.5% të fondit total të shpallur për tenderim.

Rezultatet dhe arritjet kryesore: Gjatë vitit 2021, në kuadër të projekteve zhvillimore përkatësisht sipas programeve të ndryshme, FSHZH ka nënshkruar 59 Marrëveshje Investimi si dhe Bashkëpunimi me NJVV-të dhe institucione të tjera me qëllim vendosjen e urave të bashkëpunimit për kryerjen në kohë, afat dhe me cilësi të projekteve zhvillimore.

Numri i proceseve gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2021 në të cilat FSHZH është palë, në total është 57 çështje, nga të cilat janë 40 procese gjyqësore aktive, 8 të pushuara dhe 9 të përfunduara. Vetëm për vitin 2021, janë në total 13 procese gjyqësore të reja. Ndërsa, nga 57 çështjet në total, FSHZH rezulton të jenë “I Paditur” në 35 çështje, “Paditës” në 5 çështje dhe “Person i tretë” në 17 çështje.

Gjatë vitit 2021, FSHZH ka menaxhuar dhe vazhdon të menaxhojë nëpërmjet njësive të saj, 15 programe të financuara nga burime të ndryshme, si Qeveria Shqiptare dhe nga Donatorët. Programet në zbatim përfshijnë një fushë të gjerë ndërhyrjesh të të gjitha tipologjive, si punime fizike (infrastruktura rrugore, rikualifikime urbane, ujësjellës-kanalizime, mbrojtje mjedisore, rikonstrukcione dhe ndërtim godinash, ndërtime dhe rehabilitime shëtitore, etj.) ashtu edhe komponentë *soft* (projektimi, mbikëqyrja, kolaudimi, ngritja e kapaciteteve menaxheriale për bashkitë, konsulenca mbi elementët e turizmit, krijimi dhe organizimi i eventeve, etj.).

Konkretisht gjatë këtij viti janë menaxhuar dhe janë në ndjekje, mbi 200 kontrata zbatimi.

Puna dhe produktet e realizuara në zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme zhvillimore, përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, mund të përmbledhet si më poshtë:

Projektimi: Janë përgatitur dhe kontrolluar rreth 78 projekt-propozime të zhvillimit, sipas përcaktimeve të programeve të FSHZH-së, nga të cilat 73 prej tyre janë konsideruar si projekte të maturuara dhe mund të vijonin procesin e detajimit apo prokurimit. Gjithashtu, për të garantuar cilësinë, si dhe certifikimin e projekteve, FSHZH ka siguruar oponencë teknike nga institucionet përkatëse për të gjithë projekt-propozimet e maturuara mbi përcaktimet ligjore në fuqi.

Pajisja me Leje: Në zbatim të legjislationit shqiptar për pajisjen me lejet përkatëse të të gjitha projekteve, FSHZH ka aplikuar dhe ka bërë të mundur plotësimin e të gjithë dokumentacionit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, leje mjedisi, leje ndërtimi, vlerësimin e impaktit social etj. Në total, gjatë vitit 2021, janë marrë 40 Leje Mjedisi nga 42 aplikime të kryera dhe 48 Leje Ndërtimi nga 66 aplikime të kryera.

Punime Ndërtimore: Gjatë këtij viti, kanë qenë në proces dhe janë ndjekur punimet për rreth 1860 objekte, sipas programeve:

- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA) me **81** objekte;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (IVR) me **32** objekte;

- Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PIUTD) me **6** objekte;
- Programi Lumi i Vlorës, si dhe programi i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale (RLRCP) me **10** objekte;
- Programi për Furnizimim me Ujë të Zonave Rurale (FUZR) me **20** objekte;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: **1711** objekte.

Dorëzimet: Gjatë vitit 2021 janë dorëzuar tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, 821 objekte, ku peshën kryesore e ka programi i rindërtimit me 775 objekte (konkretisht 34 objekte arsimore, 37 godina kolektive, 704 banesa individuale).

Shëndeti, Siguria në punë dhe Mbrojtja e Mjedisit: Përgjatë vitit 2021, FSHZH ka monitoruar aspektin mjedisor dhe social për 307 objekte, si dhe ka kontrolluar dhe inspektuar për sigurinë dhe shëndetin në punë 184 objekte në total. Inspektimet janë kryer në mënyrë periodike dhe në varësi të problematikave në terren.

Transparenca dhe komunikimi me publikun: Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021, ka vijuar puna për të koordinuar në mënyrë efektive komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim sigurimin e bashkëpunimit optimal të strukturave të organizatës, mbajtjen e marrëdhënieve me aktorët e interesit, si dhe konsolidimin e imazhit të FSHZH përballë palëve të treta.

Gjatë vitit 2021 janë administruar 394 kërkesa zyrtare për informacion nga qytetarë, media, zyra avokatie, gazetarë të pavarur, nga platforma e bashkëqeverisjes, apo nga institucione të ndryshme.

Platformat e komunikimit online si Facebook, Instagram, LinkedIn, YouTube dhe faqja zyrtare web, janë përdorur si një instrument për të konsoliduar reputacionin dhe imazhin e organizatës. Janë realizuar gjithsej 52 materiale vizuale për prezantimin e ecursë së punimeve dhe prezantimin e objekteve të përfunduara, pjesë e programeve të ndryshme. Shikueshmëria për këto materiale audiovizuale të përgatitura është rreth 250,000 shikime për material. Faqja zyrtare web gjatë kësaj periudhe ka pasur 301,965 shikime dhe në të janë publikuar rreth 111 artikuj të shkruar me fokus projektet e reja, për të cilat FSHZH ka filluar zbatimin në disa qarqe kryesore të vendit.